

20252084121

МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА

Në bazë të nenit 35 paragrafit (3) të Ligjit për Arsimin e të Rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 3/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

R R E G U L L O R E **PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E REGJISTRIT TË OFRUESVE TË** **AKREDITUAR TË SHËRBIMEVE PËR VALIDIMIN E ARSIMIT JOFORMAL DHE** **TË MËSIMIT ME PËRVOJË (INFORMAL)**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet forma dhe përmbajtja e regjistrit të ofruesve të akredituar të shërbimeve për validimin e arsimit joformal dhe të mësimit me përvojë (informal) (në tekstin e mëtejshëm: validimi).

Neni 2

Regjistri nga neni 1 i kësaj rregulloreje, i cili mbahet në formë elektronike, përmban të dhëna për çdo institucion të akredituar për validim, si dhe të dhëna për kualifikimin për të cilin është marrë akreditimi, dhe atë:

1. Të dhëna për institucionin e validimit:

- numri i regjistrit të institucionit;
- data e regjistrimit në regjister;
- emri i institucionit të validimit;
- selia dhe adresa;
- numri i telefonit;
- adresa e email-it;
- drejtori/personi i autorizuar;
- numri dhe data e lëshimit të aktvendimit për akreditim;
- data e ndalimit të punës së institucionit, arsyeja për të cilën fshihet nga regjistri dhe
- shënime për kontrollet ose inspektimet e kryera nga organet kompetente.

2. Të dhëna për kualifikimin për të cilin institucioni është akredituar:

- numri i regjistrimit;
- data e regjistrimit;
- titulli i kualifikimit;
- numri arkivor i Aktvendimit për akreditim për validim;
- data e akreditimit për validim;
- data e vlefshmërisë së akreditimit të institucionit të validimit;
- adresa e vendit të realizimit të validimit;
- emri dhe mbiemri i këshilltarit të përfshirë në realizimin e procesit të validimit;
- emri dhe mbiemri i vlerësuesit të përfshirë në realizimit të procesit të validimit;
- numri i pjesëmarrësve në procesin e validimit;
- gjinia e pjesëmarrësve;
- mosha e pjesëmarrësve;
- baza për shlyerje dhe
- shënime për verifikim.

Neni 3

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit të saj në "Gazetën Zyrtare të Repub-likës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.18-12806/1
3.10.2025
Shkup

Ministër i Arsimit
dhe Shkencës,
Prof. Dr. **Весна Јаневска**, d.v.